

## BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR TETOR - DHJETOR 2009

*Forumi i Tretë i Hapur me sistemin bankar në Shqipëri*

Në vijim të takimit teknik të zhvilluar me bankat gjatë muajit gusht, në datën 13 tetor 2009, Banka e Shqipërisë organizoi Forumin e Tretë të Hapur të sistemit bankar shqiptar. Si edhe në forumet e mëparshme të kësaj natyre, të pranishëm ishin drejtues dhe specialistë të Bankës së Shqipërisë dhe të bankave që operojnë në sistemin bankar shqiptar.

Diskutimet u ndalën në një sërë çështjesh të rëndësishme jo vetëm të momentit, por edhe lidhur me pritshmëritë për të ardhmen. Kështu, linja e parë e diskutimit e trajtuar gjatë Forumit lidhej me përgjegjshmërinë në drejtim, e parë kjo në kuadër të forcimit të sistemeve të kontrollit, përmirësimit të kapaciteteve të administrimit të rrezikut, investimeve në burime njerëzore dhe teknologji, si dhe të transparencës me klientin dhe me tregun. Linja e dytë e diskutimeve trajtoi zhvillimin e veprimtarisë, duke u ndalur në vendosjen e një ekuilibri më të mirë përsa i takon përbërjes së aktiv-pasive sipas monedhës, afatit të maturimit, normës së interesit; qëndrueshmërinë e burimeve të financimit dhe zgjidhjen e sfidave të likuiditetit; dhe ciklikalitetin dhe nevojën për trajtimin e tij. Në përfundim, duke diskutuar mbi pritshmëritë e sistemit bankar për të ardhmen, u fol për zhvillimet kryesore në standardet ndërkombëtare dhe shkallën e ndikimit të tyre në veprimtarinë bankare dhe kuadrin rregullativ mbikëqyrës, si dhe për mënyrën me të cilën pritet që këto zhvillime të ndikojnë veprimtarinë bankare në afat të shkurtër dhe të mesëm.

*Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani me Zëvendësministrin e Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Italisë, z. Adolfo Urso*

Në datën 14 tetor 2009, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani, zhvilloi një takim me Zëvendësministrin e Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Italisë, z. Adolfo Urso, në krye të një delegacioni të përbërë nga përfaqësues të kompanive të ndryshme italiane, të cilët morën pjesë në panairin Fiera del Levante të organizuar në Tiranë, në datat 14-17 tetor 2009.

Guvernatori Fullani njohu delegacionin italian me zhvillimet kryesore në ekonominë shqiptare dhe me masat konkrete që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit, dhe minimizimin e efekteve të krizës botërore, duke ndikuar në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe krijimin e një klime pozitive biznesi. Nga ana e tij, Zëvendësministri Urso vlerësoi reformat e kryera nga Shqipëria, e cila ka hedhur hapa të fuqishëm dhe të konsoliduar vitet e fundit në shumë drejtime, ku padyshim një kontribut të veçantë ka dhe Banka e Shqipërisë, si autoriteti monetar i vendit me politika të kujdesshme dhe vizionare. Duke përfutur nga rasti, Guvernatori Fullani ka ftuar investitorët italianë të vazhdojnë mbështetjen dhe investimet e tyre në Shqipëri, e cila ofron një potencial të fuqishëm, me burime natyrore ende të pashfrytëzuara, kapital njerëzor të kualifikuar dhe infrastrukturë moderne në zhvillim.

Në datë 29 tetor 2009, në kuadër të pjesëmarrjes në konferencën e organizuar me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani ka dhënë një leksion në Universitetin e Prishtinës, me temë "Ekonomia shqiptare përballë sfidave të kohës dhe perspektivës evropiane". Në këtë leksion morën pjesë studentë të Fakultetit Ekonomik dhe atij Juridik të Universitetit të Prishtinës si dhe stafi pedagogjik i këtij universiteti.

*Leksion i Guvernatorit në Universitetin e Prishtinës*

Në datën 16 nëntor 2009, me ftesë të z. Drini Salko, Përgjegjës i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani mbajti në Universitetin Bujqësor të Tiranës leksionin me temë "Politikat e Bankës së Shqipërisë në kuadrin e krizës globale". Duke folur për krizën globale dhe ndikimet e saj në ekonominë shqiptare, Guvernatori Fullani u ndal në mënyrë të veçantë mbi rëndësinë dhe nevojën e ndjekjes së politikave agrare të përshtatshme për të stimuluar ekonominë.

*Leksion i Guvernatorit në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe "Dita e Bankës"*

Leksioni i Guvernatorit Fullani u shoqërua edhe me organizimin e "Ditës së Bankës" në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Gjatë këtij aktiviteti, studentët por edhe akademikët e universitetit u njohën më nga afër me botimet e Bankës së Shqipërisë. Me këtë rast, atyre iu shpërndanë shumë raporte dhe buletine periodike, materiale studimi dhe kumtesa të konferencave shkencore, broshura edukative dhe fletëpalosje informuese, të cilat publikohen nga Banka e Shqipërisë në kuadër të transparencës dhe përgjegjshmërisë për informimin e publikut.

Në kuadër të zhvillimit të dialogut të hapur me aktorët e ndryshëm të ekonomisë si dhe nisur nga zhvillimet e fundit në ekonominë shqiptare dhe atë botërore, në datën 23 nëntor 2009, Banka e Shqipërisë organizoi një takim me përfaqësuesit e bizneseve kryesore që operojnë në Shqipëri.

*Forumi i Bankës së Shqipërisë me përfaqësuesit e bizneseve kryesore që operojnë në Shqipëri*

Si pjesa më dinamike e ekonomisë shqiptare, kontributi i biznesit ka qenë i prekshëm në zhvillimin ekonomik të vendit gjatë viteve të tranzicionit. Iniciativa, vullneti dhe përkushtimi i këtij sektori kanë sjellë rezultate të prekshme në zhvillimin e vendit. Duke vlerësuar kontributin e sektorit të biznesit, Forumi i Bankës së Shqipërisë diskutoi çështje që lidhen me situatën aktuale të ekonomisë shqiptare, daljen e vendit nga kriza dhe vështirësitë potenciale që mund të ketë ekonomia jonë gjatë vitit 2010. Gjithashtu, Forumi synoi fillimin e një diskutimi të gjerë publik mbi alternativat e modeleve të rritjes ekonomike në të ardhmen.

Në datat 3-4 dhjetor 2009, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Center of Excellence in Finance (CEF) – Slloveni, si dhe me mbështetjen e Komisionit Evropian, Bankës Qendrore Evropiane dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, organizoi takimin "Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave". Ky takim adresoi sfidat kryesore që shoqërojnë hartimin dhe ankorimin e politikave, me një theks të veçantë në ndërtimin e kapaciteteve individuale dhe institucionale në këtë fushë shumë të rëndësishme.

*Takimi "Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave"*

Takimi u organizua për herë të parë në Shqipëri dhe mbledhi përfaqësues nga bankat qendrore dhe ministritë e financave të vendeve të Evropës Juglindore si: Bosnje – Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Turqia, Serbia, Shqipëria. Lektorët kryesorë ishin nga Center of Excellence in Finance (CEF), Komisioni Evropian, Banka Qendrore Evropiane dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Në fjalën e tij të hapjes, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani theksoi rëndësinë e ndërtimit të politikave të duhura ekonomike për të identifikuar, modelin e ri të rritjes ekonomike, post krizë, në qendër të të cilit do të jetë thithja e kapitalit të huaj në rajon. Ai sugjeroi ndërmarrjen e politikave fiskale që shmangin rrezikun si dhe ndërmarrjen e reformave të duhura strukturore për përmirësimin e mjedisit të biznesit, të cilat natyrshëm do të ndihmojnë në rritjen e flukseve të reja hyrëse të kapitalit dhe do të çojnë drejt një rritjeje të fuqishme dhe të qëndrueshme të tyre.

Gjatë diskutimit me pjesëmarrësit, Guvernatori Fullani parashtroi nevojën për të kthyer institucionet evropiane dhe procesin e integritit në një ancorë të jashtme të mirëfilltë, të fortë dhe eficiente. Sipas Guvernatorit, forcimi i ankorave të jashtme në një periudhë afatmesme është një domosdoshmëri, dhe politikat evropiane apo vetë institucionet e BE-së mund dhe duhet ta luajnë këtë rol. Njësoj të rëndësishme janë dhe ankorat e brendshme të vendeve të rajonit, duke nënkuptuar hartimin e politikave ekonomike financiare të shëndosha nga njëra anë dhe krijimin e kapaciteteve të duhura për asimilimin dhe zbatimin e tyre në praktikë nga ana tjetër.

*Faza finale e konkursit  
"Vlera e vërtetë e parasë"  
për vitin shkollor 2008-2009*

Në datën 13 dhjetor 2009, në sallën kryesore të Akademisë së Arteve në Tiranë u organizua takimi final i konkursit "Vlera e vërtetë e parasë" për vitin shkollor 2008-2009. Konkursi "Vlera e vërtetë e parasë" është një sfidë midis ekipeve të shkollave të mesme, mbi njohuritë e tyre për Bankën e Shqipërisë, politikën e saj monetare, instrumentet që ajo përdor si dhe ndikimin e vendimeve të bankës qendrore në ekonominë e vendit.

Të vendosura përballë Jurisë së Konkursit, të kryesuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, ishin shkollat fituese të këtij konkursi për rrethet e Vlorës, Shkodrës, Korçës, Gjirokastrës dhe Tiranës. Kështu, rrethet e mësipërme u përfaqësuan nga shkollat: "Ali Demi" - Vlorë; "28 Nëntori" - Shkodër; "Themistokli Gërmenji" – Korçë; "Siri Shaplllo" – Gjirokastrë; dhe "Tirana Jonë" – Tiranë. Përveç pyetjeve të shpejta, finalistëve të konkursit iu desh ta vendosnin veten në pozitën e Këshillit Mbikëqyrës të një banke qendrore, për të analizuar situatën hipotetike të ekonomisë së një vendi dhe për të marrë një vendim mbi normën bazë të interesit të politikës monetare. Në përfundim të konkurrimit, Juria e Bankës së Shqipërisë i vlerësoi skuadrat jo vetëm mbi njohuritë e tyre, por edhe mbi aftësitë analitike të argumentimit të përgjigjeve dhe punës në grup dhe bazuar në pikët e grumbulluara shpalli fituese të konkursit shkollën "Themistokli Gërmenji" nga qyteti i Korçës.

Me rastin e mbylljes së vitit, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani zhvilloi një takim me gazetarë të njohur të shtypit të shkruar dhe medias elektronike, analistë të politikës dhe të ekonomisë, drejtues dhe përfaqësues të tjerë të mediave në Shqipëri. Guvernatori vlerësoi kontributin e gazetarëve për përcjelljen e mesazheve të Bankës së Shqipërisë dhe shprehu besimin e tij se edhe në të ardhmen analizat dhe komentet mediatike do të vazhdojnë të jenë objektive dhe realiste.

*Takim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, me gazetarë, analistë dhe drejtues të mediave, 22 dhjetor 2009*

Fillimisht, Guvernatori ravijëzoi një ekspozë të ekonomisë shqiptare, duke theksuar se 2009 ishte një vit, i cili u karakterizua nga shumë ngjarje përfshirë këtu edhe krizën globale. Ai theksoi se falë punës së Bankës së Shqipërisë është bërë e mundur ruajtja dhe konsolidimi i stabilitetit makroekonomik të vendit si dhe i qëndrueshmërisë financiare të sistemit bankar. Përveç kontributit të saj në ruajtjen dhe konsolidimin e stabilitetit makroekonomik të vendit, Banka e Shqipërisë është e përfshirë edhe në shumë projekte të tjera, të cilat kanë një vlerë specifike të shtuar për gjithë shoqërinë shqiptare. Në këtë kontekst, Guvernatori prezantoi disa nga angazhimet e bankës qendrore për edukimin e publikut, për inaugurimin e Institutit të Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë në qytetin e Beratit dhe për prezantimin e kalendarit 2010 të Bankës së Shqipërisë, si një mënyrë për promovimin e qyteteve ilire dhe monedhave që janë prerë dhe përdorur në to.

Departamenti i Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë organizon dy herë në muaj të ashtuquajturin "Seminari i të Premtes". Kjo iniciativë fton nëpunësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare, kërkimore dhe shkencore, të prezantojnë dhe diskutojnë me njëri-tjetrin materialet e tyre kërkimore teorike dhe empirike, me fokus mbi rastin e Shqipërisë dhe mbi aplikimin e metodave më të reja kërkimore.

*Seminari i të Premtes*

Pjesë e Seminarit të të Premtes, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2009, kanë qenë pesë studime. Punimi i parë i prezantuar ishte ai i Lorina Green dhe Rezart Erindi, Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë, me temë "Përdorimi i modelit KMV-Merton për të parashikuar mundësinë e dështimit të firmave në shlyerjen e borxhit të emetuar". Për shkak të shtimit të produkteve të borxhit të emetuar nga firmat dhe të përdorimit gjithnjë e më të madh të derivatëve të kreditit ka pasur një interes në rritje për modele që parashikojnë mundësinë e dështimit të firmave në shlyerjen e borxhit të tyre. Një model që sjell risi në parashikime, i aplikuar gjerësisht si në praktikë ashtu dhe në kërkimet akademike, është një zbatim i veçantë i modelit të Merton-it (1974) zhvilluar nga korporata KMV. Ky material ka si qëllim prezantimin e këtij modeli dhe parashtron mundësinë për vënien në përdorim të tij brenda Bankës së Shqipërisë.

Studimi i radhës me autorë Rezart Erindi dhe Valbona Luga, Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë, titullohej "Përzgjedhja e benchmark-ut strategjik. Aspekte teorike dhe praktike". Përzgjedhja e benchmark-ut strategjik mund të përshkruhet si procesi nëpërmjet të cilit një institucion vendos për mënyrën e shpërndarjes neutrale të investimit

(instrumenteve financiare) në çdo moment të kohës, për të arritur objektivat afatgjata të investimit. Në këtë material, autorët përqendrohen në hapat e fundit të procesit duke përshkruar metodologjinë që ndiqet për ndërtimin e propozimeve për benchmark-un strategjik dhe vlerësimin në kohë të kësaj metodologjie. Gjithashtu, ata përcaktojnë dhe klasat e instrumenteve të lejuara për investim.

Në muajin nëntor, Armela Mançellari nga Departamenti i Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë, prezantoi materialin "Nowcasting GDP - Vlerësimi afatshkurtër i PBB-së reale". Qëllimi i këtij materiali është ndërtimi i modeleve për parashikimin afatshkurtër të vlerës së PBB-së së vendit për tremujorin aktual. Meqenëse, të dhënat mbi PBB-në tremujore në Shqipëri publikohen me 12 javë vonesë, për të realizuar një vendimarrje të mirinformuar nevojitet parashikimi i ecures së këtij treguesi përpara publikimit të tij. Autorja përdor të dhëna nga: shitjet reale, shitja dhe riparimi i automjeteve dhe komponentët e indekseve të besimit, për të parashikuar PBB-në e tremujorit aktual me ndihmën edhe të modeleve ekonometrike.

"A ekziston multiplikatori i politikës fiskale? Reagimet fiskale dhe monetare, kredibiliteti dhe multiplikatorët fiskalë në Hungari" ishte studimi i prezantuar nga Zoltan Jakab, Drejtor i Analizës Makroekonomike, Zyra e Këshillit Fiskal, Republika e Hungarisë. Materiali ka për qëllim vlerësimin e multiplikatorëve të politikës fiskale në Hungari nëpërmjet përdorimit të modelit DSGE. Rezultatet tregojnë se multiplikatorët e treguesve të ndryshëm të politikës fiskale ndryshojnë nga njëri tjetri. Ata ndryshojnë edhe kur merren parasysh mënyrat se si do të finanohet ekspansioni i politikës fiskale në të ardhmen. Perceptimi i agjentëve të ekonomisë mbi vazhdueshmërinë e stimulit fiskal ka një ndikim të rëndësishëm mbi multiplikatorët. Gjetjet sugjerojnë se në një ekonomi të vogël dhe të hapur, ku politika monetare reagon më së shumti ndaj inflacionit, akomodimi që ajo i bën politikës fiskale nuk ka ndikim mbi multiplikatorët fiskalë.

Për vitin 2009, "Seminari i të Premtes" u mbyll me diskutimin e materialit me temë "Modelimi i PBB-së tremujore - roli i treguesve ekonomikë dhe atyre të vrojtimit", i punuar nga Evelina Çeliku, Ermelinda Kristo, Merita Boka, Departamenti i Politikës Monetare në Bankën e Shqipërisë. Qëllimi i materialit është vlerësimi në terma afatshkurtër i prirjes së PBB-së tremujore në rastin e Shqipërisë nëpërmjet tri përfaqësive kryesore: a. Modele Arima me përbërës sezonalë; b. Modele indikatorë – urëlidhës; dhe c. Modele VAR. Këto modele kanë mundësuar përfitimin e vlerësimeve paraprake mbi dinamikën e aktivitetit ekonomik rreth prirjes kryesore për tremujorin referues (nowcast) dhe për deri në dy tremujorë në vijim (parashikim). Materiali arrin në përfundimin se variablat nga vrojtimet përmbajnë informacion të vlefshëm për parashikimet afatshkurtra të PBB-së tremujore. Gjithashtu, parashikimi "më i mirë", merret nga mesatarja e parashikimeve nga modelet e ndryshme (pa përfshirë modelet ARIMA). Së fundi, performanca e parashikimit jashtë periudhës do të jetë ajo që do të luajë rol ponderues në përzgjedhjen e modeleve më të përshtatshme në llogaritjen e parashikimit mesatar.